



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:190654  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05640307

**PA1.nr.19/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.Z nga fshati..., Komuna e Suharekës dhe D.G nga fshati .., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale, Vjedhje e rëndë nga neni 315 par. 1 nën par 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, D.G, av. D.F të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.364/22 të dt.28.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 22.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, D.G, av. D.F, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.364/22 i datës 28.04.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Prizren -Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, me aktgjykimin P.nr.364/22 i datës 28.04.2023, të akuzuarin, D.G e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale, Vjedhje e rëndë nga neni 315 par. 1 nën par 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti , të cilin dënim duhet të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe dënim me gjobë në shumën prej 200 € ( dyqindtë euro) të cilin duhet t’ia paguaj 15 ditë nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi. Në çoftëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim

me burgim, ashtu që 20 € (njëzet) euro e dënimit me gjobë llogaritet me 1 (një) ditë burgim. Obligohen të akuzuarit t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 € (njëzetë euro), secili veç e veç dhe në emër të taksës për kompensim të viktimave të krimit shumë prej 20 € (njëzetë euro), secili veç e veç të gjitha këto pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyruar ligjor. I dëmtuari Fadil Halitjaha nga fshati Mushtisht komuna Suharekë për kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit D.G, av. D.F, për shkak të vendimit mbi llojin dhe lartësinë e sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar ashtu që dënimin më burg në kohëzgjatje prej 1 vit do ta kushtëzoj (i cili nuk do të ekzekutohet në periudhën e verifikimit prej 1 viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit kurse do ti zvogëloj dënim e shqiptuar me gjobë prej 200 € në 100 €.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.29/2024 të datës 12.01.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së në të cilën palët ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.G, av. D.F, ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me pretendimet se gjykata e shkallës së parë edhe për kundër faktit kur thekson se ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit, ato vetëm deklarativisht i thekson kurse jo dhe një zbatim faktik dhe real të njëjtave rrethana kur bënë matjen-shqiptimin e dënimit. Më rastin e caktimit të dënimit me gjobë gjykata ka qenë e obliguar të vërtetoj dhe të marrë parasysh gjendjen pasurore të kryerësit posaçërisht shumë e të ardhurave personale dhe të ardhurave të tjera, pasurin dhe detyrimet e tij që në fakt për aq sa këto i posedon apo dhe mund të deklarojmë se asnjërin prej këtyre nuk posedon, bëjnë se gjykata ka shqiptuar dënimin më gjobë në lartësinë mbi mundësin e të akuzuarit. Kurse sa i përket dënimit me burg gjykata ka qenë dashtë ta vlerësoj sjelljen e më parshme e që në rastin konkret kemi të bëjmë me një kryerës të veprës që përherë të parë ka qenë në kundërshtim me ligjin, sjelljen pas kryerjes së veprës e sjellja e të akuzuarit ishte një sjellje korrekte pranë gjykatës , i pa punë e pa kurrfarë të ardhura personale, gjendja ekonomike e dobët, i martuar dhe i moshës relativisht të re dhe ishte deklaruar se është i penduar për veprën e kryer.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të ulët për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit në pajtim me dispozitat e nenit 69 të KPK-së, pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë në mënyrë të sinqertë pa presion, me vullnet, se ndihet i penduar për veprën penale të cilën e ka kryer dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do t'i përsërisë asnjëherë këtë veprë penale, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti.

Një vlerësim të këtyllë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e të akuzuarit, nuk kanë ndikim që të akuzuarit ta liroj nga akuza. Të gjitha këto rrethana, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjeneralë, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PA1.nr.19/2024, më datë 22.03.2024.**

**Procesmbajtësja,**  
Gentijana Manaj-Gashi

**Anëtarët e kolegjit:**  
Skender Çoçaj

**Kryetar i kolegjit,**  
Ferit Osmani

Abdullah Ahmeti